

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-182/11**

**Prishtinë, 22 qershor 2012**

Në çështjen e

**D.L.**

*Pala ankuese*

I përfaqësuar nga

**M.L.**

*Paraqitësja e kërkesës*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/AR/101/2011 (lëndët janë regjistruar në AKP me numrat KPA08466, KPA08469, KPA08471 dhe KPA08473), të datës 23 shkurt 2011, pas seancës së mbajtur me 22 qershor 2011, mori këtë

## AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e D.L..
- 2- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro), të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 11 janar 2007, M.L., duke vepruar si anëtare e familjes së ngushtë në emër të vjehrit të ndjerë ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njihet si pronare e ngastrave të ndryshme të tokës të fituara me anë të trashëgimisë dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ajo ka sqaruar se këto ngastra i përkisnin vjehrit të saj të ndjerë M.L.. Ajo ka thënë se prona ishte uzurpuar si rezultat i rrethanave të vitit të viteve 1998/1999 në Kosovë dhe se datat e humbjes ishte 12 qershori 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKM dokumentet në vijim:

- Certifikatën e saj të martesës
- Fletën poseduese nr. 38 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Podujevës për Komunën Kadastrale të Peranit me 3 tetor 1997.

Fleta poseduese nr. 38 ka treguar në mesin e ngastrave tjera M.N.L. ishte pronar i ngastrave të kërkuara në vijim:

Numri i ankesës dhe lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-182/11 (KPA08466)	Ngastra nr. 128, në vendin e quajtur "Sojiste", Peran, pronë komerciale pa objekt, livadh i klasës 3 me sipërfaqe prej 73 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-183/11 (KPA08469)	Ngastra nr. 137 dhe 138, që të dyja në vend e quajtur "Utrina", Peran, pronë komerciale pa objekt: Nr. 137 arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 4 hektarë, 02 ari e 79 m <sup>2</sup> , Nr. 138 livadh i klasës 3 me sipërfaqe prej me sipërfaqe prej 2 hektarë, 22 ari e 14 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-184/11 (KPA08471)	Ngastra nr. 312, në vendin e quajtur "Sojiste", Peran, pronë komerciale pa objekt, kullosë e klasës 2 me sipërfaqe prej 5 ari e 55 m <sup>2</sup>

GSK-KPA-A-185/11 (KPA08473)	Ngastra nr. 512, në vendin e quajtur “Lebeske Njive – Kod D”, Peran, pronë komerciale pa objekt, arë e klasës 2 me sipërfaqe prej 18 ari e 31 m <sup>2</sup>
--------------------------------	--

AKP-ja e ka bërë notifikimin së pari në vitin 2007 duke vendosur shenja në vendin ku supozohej se ndodheshin ngastrat e kërkua. Në vitin 2010, është përsëritur notifikimi. Këtë herë AKP-ja e kishte publikuar kërkesën në Gazetën Zyrtare të AKP-së dhe kishte shpërndarë gazetën në disa lokacione në fshat dhe në disa zyra dhe institucione përgjegjëse për kadastër dhe për procesimin e kërkesave për të drejtat pronësore..

Fleta poseduese nr. 38 si dhe certifikata e martesës së paraqitëses së kërkesës ka mundur të verifikohet.

Me 20 mars 2008, AKP-ja ka kontaktuar me paraqitësen e kërkesës dhe ka kërkuar nga ajo që ta paraqes certifikatën e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore si dhe dokumentet tjera, ndër të tjera autorizimin e trashëgimitarit të mundshëm të pronës. Përkundër afatit prej tridhjetë ditëve, paraqitësja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dokument tjetër. Me 2 prill 2009, AKP-ja ka kontaktuar përsëri me paraqitësen e kërkesës dhe i ka dhënë një afat prej tridhjetë ditëve për të paraqitur autorizimin të trashëgimitarëve të mundshëm. Megjithatë, paraqitësja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dokument. Me 13 dhjetor 2010, paraqitësit të kërkesës edhe një herë i është kërkuar që të paraqes autorizimin nga trashëgimitarët e mundshëm dhe është informuar se përndryshe kërkesa mund të hedhet poshtë.

Me 23 shkurt 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/101/2010 e ka hedhur poshtë kërkesën. Sipas nr. 33 të vendimit të tij, Komisioni ka theksuar se paraqitësja e kërkesës nuk ishte anëtare e familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore. (neni 5.2 i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079), ajo është dashur të tregoj autorizimin e saj për të vepruar në emër të bartësit të së drejtës pronësore – apo të anëtarit të familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore – me anë të autorizimit të vlefshëm. Megjithatë, paraqitësja e kërkesës, e cila ishte pajtuar që të paraqiste autorizimin e dhënë nga njëri prej trashëgimitarëve, nuk ka paraqitur një dokument të tillë, ndonëse ajo është kontaktuar nga AKP-ja në raste të shumta..

Vendimi i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës me 26 shtator 2011. Me 24 tetor 2011, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur disa ankesa identike në Gjykatën Supreme, secila nga to kishte të bënte me një

kërkesë të veçantë, ky katër nga to kishin të bëjnë me kërkesat të cilat janë çështje e këtij vendimi, ndërsa dy të tjerat lidhur me një vendim tjetër të KKKPK-së.

Paraqitësja e kërkesës tani kërkon që Gjykatat Supreme t'i jap të birit të saj D.L. të drejtën e posedimit të pronës së regjistruar si pronë e M.L. dhe që ndodhet në komunën kadastrale të Peranës.

Paraqitësja e kërkesës ka sqaruar se vjehri i saj i ndjerë, M.L., kishte vdekur me 11 dhjetor 1989. Pala ankuese më tej ka sqaruar se bashkëshorti i saj, J.L., kishte vdekur me 29 gusht. Pas vdekjes së vjehrrit, procedura e trashëgimisë ishte kryer dhe i biri i saj, D.L., ishte shpallur si njëri prej trashëgimtarëve.

Ajo ka paraqitur ndër të tjera edhe dokumentet në vijim:

- Certifikatën e vdekjes të lëshuar me 27 shtator 2007 nga Republika e Serbisë, Komuna e Podujevës, në Nish, e cila konfirmon se M.L. kishte vdekur me 11 dhjetor 1989 Peranë;
- Certifikatën e vdekjes të lëshuar në vitin 1987 nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, Komuna e Novi Pazarit, e cila konfirmon se J.L. me vendbanim të përheshën në Novi Pazar, Jovana Ristovica nr. 3, kishte vdekur me 29 gusht 1986 në Novi Pazar;
- Aktgjykimin II O. Nr. 7/93, të lëshuar me 1 nëntor 1993 nga Gjykata Komunale e Kurshumlisë/Departamenti Podujevë, i cili ndër të tjera cek se D.L. është trashëgimtar i 1/10 së M.L..

Në ankesës e saj pala ankuese për më tepër ka deklaruar se nuk do të paraqiste kërkesë në emër të saj ose në emër të vjehrrit të saj, por në emër të të birit , D.L., i cili ishte pasardhës ligjor i bartësit të së drejtës pronësore, gjyshit të tij të ndjerë M.L.. Pala ankuese më tej ka cekur pa ndonjë sqarim të mëtutjeshëm se i biri i saj nuk ka qenë në gjendje që të paraqes kërkesë në emër të tij në kohën kur është dashur të paraqitej kërkesa. Ajo ka thënë se e kishte marrë autorizimin nga i biri i saj para se ajo të paraqiste kërkesën. Për të mbështetur këtë pohim, ajo ia ka paraqitur Gjykatës Supreme një autorizim, që cek se D.L. e kishte autorizuar paraqitësen e kërkesës për t'i paraqitur kërkesat – parashtrajtje ankesat lidhur me vendimin e AKP-së në lëndët KPA08466, KPA08469, KPA08471, KPA08473, KPA08476 dhe KPA08477 si dhe për tërë pronën e regjistruar në fletën poseduese “Nr. 33”. Paraqitësja e kërkesës ishte autorizuar që të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në procedurë. Autorizimi ishte lëshuar në Beograd, është i datës tetor 2011, ndërsa nënshkrimi është i palexueshëm. Nënshkrimi është certifikuar me nr. 13318/2011 nga gjykatat Komunale e Novi Pazarit me 10 qershor 2011.

Gjykatat Supreme i ka bashkuar ankesat sipas nenit. 408.1 të LPK-së. Pala/palët, faktet dhe çështjet ligjore janë të njëjta, vetëm ngastrat janë të ndryshme. Në këtë mënyrë, bashkimi i ankesave jo vetëm që siguron efikasitetin e lëndës, por ai gjithashtu zvogëlon shpenzimet e procedurës. Lëndëat GSK-KPA-A-183/11 (KPA08469), GSK-KPA-A-184/11(KPA08471) dhe GSK-KPA-A-185/11(KPA08473) bashkohen me lëndën GSK-KPA-A-182/11 (KPA08466).

### **Arsyetim ligjor:**

Gjykatat vëren se ankesa është paraqitur nga M.L. vetën në pozitën e saj si përfaqësuese e të birit të saj D.L.. Prandaj, M.L. nuk është palën në procedurë por D.L..

Megjithatë, ankesa e D.L., është e papranueshme mbi bazën procedurale (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh: “Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, **pala** mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë [...]”. (potencim nga Gjykatat).

Megjithatë, D.L., nuk ka qenë palë në kërkesë në procedurën para KKPK-së. Kërkesa është paraqitur nga nëna e tij, M.L.. Ajo e ka mbështetur kërkesën e saj gjatë tërë procedurës para KKPK-së dhe është informuar se ishte i nevojshëm autorizimi, M.L. është pajtuar që të paraqes autorizimin e dhënë nga njëri prej trashëgimtarëve të bartësi të së drejtës pronësore, M.L.; megjithatë ajo asnjëherë nuk e ka paraqitur një autorizim të tillë. Madje edhe më vendimtar është fakti se ajo madje asnjëherë nuk e ka përmendur se do ta përfaqësonte një person të caktuar, të përfaqësonte të birin D.L.. Emri i tij asnjëherë nuk është përmendur në procedurën para AKP-së.

Në këtë mënyrë, KKPK-ja ka nxjerrë konkludim të drejtë se palë në procedurë ka qenë vetëm, M.L.. Pra, D.L. nuk ka qenë palë në kërkesë.

Gjykatat nuk shoh ndonjë indikacion se D.L. nuk kishte qenë në gjendje të marrë pjesën procedurën para AKP-së (shih gjithashtu nenin 12.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 as të ndryshuar me Ligin Nr. 03/L-079 dhe nenin 258.4 (a) të LPK-së). Në ankesë, M.L. si përfaqësuese e të birit pohon se ai nuk ka qenë në gjendje që të paraqesë kërkesën. Megjithatë, ajo nuk paraqet ndonjë fakt se përse

ai nuk ka qenë në gjendje që ta paraqes kërkesën. Për me tepër, ajo nuk jep ndonjë arsye se përse nuk e kishte përmendur se po e përfaqësonte të birin në procedurën para AKP-së dhe nuk jep ndonjë arsye se përse ajo nuk ia kishte paraqitur AKP-së autorizimin e dhëna nga i biri. Si rrjedhojë, Gjykatat nuk gjen ndonjë arsye të veçantë se përse D.L. duhet të ketë të drejtë që të paraqes kërkesë.

Një vendim tjetër, me anë të së cilit do të lejohej ndryshimin i paraqitësit të kërkesës/palës ankuese madje edhe procedurën sipas ankesës, do të ishte shmangie nga neni 8 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, sipas të cilit kërkesat duhet të paraqiten në Sekretarinë Ekzekutive në ose para skadimit të afatit prej gjashtë muajve nga data e shpalljes së Urdhëresës Administrative (shpallja: 1 qershor 2007). Po të lejohej ndryshimi i paraqitësit të kërkesës/palës ankuese, paraqitësi i ri i kërkesës/pala ankuese do ta kishte statusin sikurse të kishte paraqitur kërkesën me kohë, ndërsa në fakt ai ka herë nuk iu kishte përmbajtur afatit (në këtë rast nuk ka hyrë në procedurë në vitin 2007 por vetëm në vitin 2011).

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në 40.000€ : 30€ (gjysmë pjesa e tarifës sipas nenit 10.1, por jo më shumë se 30 €).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë

se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin tanishëm tarifat gjyqësore duhet të paguhen nga pala ankuese brenda 90 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Neni 47.3 parasheh së në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Philip Drake, Rexhistrues i EULEX-it**